

STUDIM KRAHASUES NDËRDISCIPLINOR I RASTIT

VETËUSHQIMI NË VITIN 2020, NË REPUB- LIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT HEJ, MAMI!

Titulli:

STUDIM KRAHASUES
NDËRDISCIPLINOR I RASTIT,
VETËUSHQIMI NË VITIN 2020, NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË
VERIUT

Botues:

Aksioni Paqësor

Autore:

Doroti Paçkova

Përktheu në shqip:

Jasmin Rexhepi

Dizajn:

Valentina Milanoviq

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje.....	5
2.	Lënda e hulumtimit.....	7
3.	Korniza teorike.....	9
4.	Metodologjia e hulumtimit.....	10
5.	Pyetje Hulumtuese.....	12
6.	Përfundim.....	28

Parathënie:

Gjatë punës, një grua mund të shohë se deri ku jemi si shoqëri, të jetë e pranishme dhe të dëshmojë një kohë në të cilën ajo do të ketë ndikim ose jo. Përmes punës zbulohen të gjitha mangësitë e sistemit, të gjitha të metat, të gjitha mungesat... për shembull, për të punuar në vend, komunikohet çdo ditë me shumë institucione, departamente në institucione, persona të ndryshëm të kontaktit, sportele, zyra, radhë. Kur kjo është pjesë e përditshmërisë, ke një pasqyrë të drejtpërdrejtë të gjërave që funksionojnë dhe atyre që nuk funksionojnë.

Kur një nënë vetushqyese është e vendosur të punojë dhe të mos dorëzohet në këtë shtet, të gjitha këto kontakte i realizon së bashku me fëmijën/t, atëherë ajo madje ka mundësinë të vendosë nëse dëshiron që fëmijët të rrotullohen në të njëjtin rreth, ose do të investojë në maksimum për ta bërë këtë rreth më të mirë.

Për të pasur paqe, për të arritur jetë të mirëqenies, duhet të jemi aktiv, megjithëse shpesh kjo do të thotë prishje e paqes personale, largim nga zona e komfortit, të jesh pjesë e shoqërive që nuk na pëlqejnë, të merresh me ata që nuk duan të punojnë, të krijosh kontakte me dhunues ... e gjithë përballja është një paqe feministe, e cila nuk është një det i qetë, por i cili valon dhe ndryshon për mirë.

Me adresimin e shkaqeve themelore të dhunës dhe trazirave me një sy feminist dhe duke u mobilizuar për veprim jo të dhunshëm në nivel lokal dhe global, ndërtohet veprimi dhe dinamika drejt paqes feministe.

Është sfidë të ndërtohet paqe, aty ku një grup i madh i njerëzve përballlet me trazira në bazë ditore, për shkak të mos funksionimit real sa i përket marginalizimit kulturor, dhe veçanërisht në mungesë të ligjeve dhe të drejtave, si dhe masave për grupin specifik të synuar.

Sidomos gjatë një pandemie, si kjo që na kapi këtë vit 2020. Ky rast studimi u krijua në kushte të jashtëzakonshme, për këtë arsye është veçanërisht i dashur për mua, dhe më siguroi thellësisht se edhe në të ardhmen, ia vlen të hulumtosh histori të tilla individuale, tregime mikro të gjalla të nënave vetushqyese.

**Me shpresën për një shoqëri që mëson të funksionojë në mirëqenie,
Doroti Paçkova, dhjetor 2020**

I. Hyrje:

Versioni fillestar i këtij studimi krahasues të rastit u krijua për të mbledhur, dokumentuar dhe publikuar prova të diskriminimit të shumëfishtë kulturor dhe institucional ndaj nënave vetushqyese nga një larmi kontekstesh. Të inkurajojë të gjitha gratë për bashkëjetesë dhe solidaritetit dhe të përforcojë ndjenjën e unitetit tek ato. Të de-normalizohet dhuna që ata përjetojnë përmes shkëputjes/de-stigmatizimit. Të merren rekomandime direkt nga grupi i synuar për t'iu paraqitur vendimmarrësve. Të rritet vetëdija publike në lidhje me diskriminimin ndaj grupit të synuar, duke kontribuar kështu në paqe për sa i përket pabarazive gjinore.

Versioni përfundimtar i këtij studimi të rastit doli nën presionin e gjendjes së jashtëzakonshme nga KOVID-19, duke mbledhur dhe sistemuar të dhëna shumë të rëndësishme në situatë ekstreme që kontribuon në trazira radikale.

Duhet të theksohet se frymëzimi për këtë rast studimi buron nga përvoja 8-vjeçare e hulumtueses në identitetin e një nëne vetushqyese së pari, dhe pastaj në identifikimin si një eksperte gjinore, kryetare e një organizate 'grassroot' të barazisë civile me një fokus në promovimin e të drejtave të nënave vetushqyese. Prandaj, ajo ka marrë pjesë në disa projekte hulumtuese dhe shkencore që punojnë mbi temën dhe problemet e prindërve të vetëm në këtë shtet, sepse dëshira e vërtetë për të jetuar një jetë me shumë sfida dhe pengesa nga mjedisi i përgjithshëm mikro dhe makro, është i vendosur ta kanalizojë atë në një mënyrë konstruktive dhe post moderne në të cilën ajo dhe i gjithë grupi i synuar dhe shoqëria do të përfitojnë dhe përparojnë shumë herë.

Duke u kthyer në vitin 2014/15, përmendet pjesëmarrja në krijimin e dokumenteve të Politikave publike të krijuara nga grupe kërkimore me titull "Nënat vetushqyese viktime të dhunës së shumëfishuar", e cila është pjesë e hulumtimit aktual të kësaj analize krahasuese, e punuar 5 vite më pas dokumentit fillestar të theksuar.

Mjetet metodologjike që ofrojnë më shumë njohuri sasiore përdoren për të krijuar dokumente të Politikave publike, veçanërisht për politikat publike në lidhje me çështjet e vajzave dhe grave, ndërsa ky studim krahasues ndërdisiplinor i rastit synon të depërtojë thellësisht në mënyrë cilësore në situatat reale të dy nënave vetushqyese, megjithëse si mbështetje e situatës së tyre do të përdoren të dhëna sasiore të mbledhura përmes një pyetësi të brendshëm dhe një pyetësi hulumtues në një publik të gjerë.

Duhet të theksohet se versioni fillestar i analizës nuk ishte planifikuar të përmbajë një pjesë të versionit përfundimtar, pikërisht për faktin se gjendja e jashtëzakonshme me KOVID-19 ndikoi tek të gjithë, veçanërisht në grupin e synuar për të cilin edhe u krijua kjo analizë.

Sistemi i menaxhimit të krizave ka marrë një dimension tjetër nga kjo perspektivë e re emergjente dhe do të ishte e pamundur të mos integroheshin të njëjtat segmente në këtë studim, i cili sigurisht do të mbetet një vulë e kohës, vitit 2020, mbi pamundësitë radikale, veçanërisht për prindërit vetushqyes dhe të gjithë anëtarët e familjeve me një prind.

Ky rast studimi mbështetet nga Programi i avancuar i ndërtimit të paqes dhe ballafaqimi me të kaluarën nga Aksioni Paqësor.

II. Lënda e hulumtimit:

Lënda e këtij studimi të rastit është amësia vetushqyese, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vitin 2020.

Hulumtimi synon t'i përgjigjet pyetjes vijuese: me çfarë lloj diskriminimi përballen nënat vetushqyese në RMV, nga dy etnitë më të mëdha, shqiptare dhe maqedonase, dhe si kontribuon diskriminimi në prishjen e paqes së tyre personale?

Çfarë duhet bërë për të mundësuar që nënat vetushqyese të të gjitha kategorive të jenë më pranë mirëqenies personale?

Situata e nënave vetushqyese do të konsiderohet përmes prizmit të një teze që përpiket t'u përgjigjet dy pyetjeve kryesore të hulumtimit, secila me nën-pyetje të veçanta:

1. Me çfarë llojesh pamundësisish dhe diskriminimi përballen, përmes intervistave të thelluara me dy nëna vetushqyese: maqedonase dhe shqiptare, dhe si ndikon kjo në shqetësimet e tyre personale?
2. Si ndikon gjendja e jashtëzakonshme nga KOVID- 19 tek nënat vetushqyese?

Për të realizuar këtë analizë krahasuese, së pari u krijua një intervistë gjysmë e strukturuar me 11 plus 7 pyetje dhe në qershor 2020 u bë një telefonatë e brendshme në platformën online të nënave vetushqyese të organizatës qytetare Njëra Mundet!, E cila është e vetmja organizatë 'grasroot' për promovim të të drejtave të nënave vetushqyese në vend.

Aplikuan 9 nëna vetushqyese, të cilave u dërguan pyetësorë për t'iu përgjigjur atyre në mënyrë të pavarur, pa ndonjë ndikim nga studiuesi i kësaj analizë krahasuese.

Përgjigjet e mbledhura u klasifikuan dhe përshtatën tek ato nëna vetushqyese që kishin një kontekst të ngjashëm të krijimit të familjes me një prind të vetëm, të cilën e udhëheqin.

Nga këto 9 nëna vetushqyese, përmes disa mjeteve vlerësuese, përfshirë nivelin e nevojës/dëshirës për të shprehur/sqaruar/ndarë situatën e tyre, u zgjodhën 2 nëna beqare me të cilat u kryen intervista të drejtpërdrejta gjysmë të strukturuar.

Për të krijuar një atmosferë të përshtatshme për intervistë, u zgjodhën vendet që ishin zona të komfortit për gratë dhe ku ato ndihen më shumë si në shtëpi, duke supozuar se ato mund të shprehen në mënyrë më të artikuluar dhe të pasqyrojnë më mirë situatën në të cilën jetojnë.

Hulumtuesja kishte një plan përgatitor të përbërë nga disa faza:

- faza hyrëse dhe në të cilën u zhvillua një dialog i rastit dhe vetë studiuesja prezantoi përvojat e saj në të qenit prind vetushqyes;
- faza përgatitore në të cilën u paraqitën qëllimet dhe rrjedha e intervistave, koha në të cilën ato mund të realizohen dhe privatësia e të gjitha të dhënave të paraqitura që vetëm studiuesi do t'i ketë në dispozicion dhe do t'i mbrojë në mënyrë adekuate në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale, dhe se do t'i përdorë ato vetëm për qëllime shkencore për studimin specifik krahasues të rastit;
- faza e realizimit përmes së cilës u përgjigjet pyetjeve nga intervista gjysmë e strukturuar, në një diapazon që i përshtatet më së miri çdo të anketuari dhe në një mënyrë që ajo vetë kishte nevojë të shprehet;
- faza joformale: në këtë fazë formulohen konkluzionet dhe përvojat e mësimave të marra përmes të gjitha pamundësive, duke u përqëndruar në motivimin për ndjekjen e mëtejshme të një ekzistence funksionale dhe sigurimin e të drejtave të nënave vetushqyese si dhe krijimin e kushteve dinjitoze të jetesës për fëmijët e familjeve me një prind.

Sa i përket kohëzgjatjes, duhet të theksohet nevoja e lartë e të anketuarve, për t'u shprehur dhe për të sqaruar vetveten, të dëgjohen dhe të kenë vëmendjen që është padysim e nevojshme dhe shumë e rëndësishme për ta.

Një fakt interesant është se tek vërejtjet mund të gjenden fraza të përsëritura që zakonisht janë në nivelin e treguesve që të anketuarit sjellin me vete dhe studiuesi synon këtë si një mundësi tjetër për kërkime dhe analiza të mëtejshme.

Në vazhdim, u publikua një pyetësor në online, të cilit ju përgjigjën 241 nëna vetushqyese, dhe ata u shprehën në mënyrë thelbësore në lidhje me pamundësitë e shkaktuara nga gjendja e jashtëzakonshme e KOVID-19.

Mjeti i fundit i hulumtimit ishte një thirrje online për mbështetje nga aktivistët dhe/ose ata që duan të vendosen dhe besojnë në përparimin e të drejtave të nënave vetushqyese. Më shumë se 15 vajza dhe gra nga e gjithë Republika e Maqedonisë së Veriut u bashkëngjiten. Ata dhanë deklaratat e tyre motivuese dhe ranë dakord të fotografohen në mënyrë që të krijojnë një eveniment përfundimtar për të promovuar këtë rast studimi, i cili në vete do të jetë një inkurajim i ndërsjellë drejt jetës dinjitoze për të cilën ata po luftojnë për veten e tyre.

III. Korniza teorike:

Ky artikull shqyrton në mënyrë selektive grupin e synuar nga një perspektivë feministe për të identifikuar idetë dhe praktikrat që kanë ndikuar në kornizën relativisht të re kërkimore të studimeve gjinore, duke marrë përvojat e gjalla të grave si referencën kryesore. Feminizmi zbërtheu disa nga diskursat mbizotëruese në studimet gjinore, hapi kufij të rinj të kërkimit, siguroi kuptime të reja për koncepte të tilla si diversiteti, pozicionet e jo/paqes, siguria, zhvillimi dhe asimetritë e fuqisë dhe ndihmoi në gjenerimin e një numri hipotezash të dobishme. Kontributi feminist në studimet gjinore mund të kuptohet në shumë fusha, por motivi më i fortë i hulumtimit për autoren e kësaj analize mbetet mundësia e ndryshimit për më mirë të jetës së grupit të synuar.

Literatura gjinore përqendrohet në një numër çështjesh në lidhje me rolet e grave në shoqëri. Ai adreson marrëdhëniet midis burrave dhe grave dhe strukturat shoqërore që dalin nga këto marrëdhënie.

Literatura gjithashtu shikon se si ruhen ndryshimet ekzistuese midis burrave dhe grave dhe zbatimin e tyre përmes sistemeve politike, diskursit publik, integritit gjinor dhe marginalizimit të grave. Kjo gjithashtu për faktin se pjesëmarrja e grave në negociatat politike dhe pozitat udhëheqëse është ende mjaft e kufizuar. Ekziston një nevojë për një debat mbi ndikimin e kontributit të grave në adresimin e diskriminimit ndaj grupeve të caktuara të synuara të vajzave dhe grave, në proceset e zhvillimit të demokratizimit në kontekste të ndryshme shoqërore.

Korniza e stereotipeve në të cilin fëmijët janë të orientuar në sistemin arsimor më të hershëm, nxitës, në RMV, nuk ndihmon për të ndryshuar perceptimet dhe pranimin në lidhje me strukturat e ndryshme familjare. Në shekullin 21, çdo e katërta familje është me një prind të vetëm, kështu që ne duhet të synojmë të rregullojmë kushtet sociale në dobi të tyre sa më shumë.

Fëmijët nga familjet me një prind i nënshtrohen diskriminimit në bazë të statusit familjar, duke filluar nga përmbajtja e librave me figura, libra ushtrimesh dhe libra për t'u ngjyrosur, dhe më vonë në librat shkollorë. Llojet e tjera të diskriminimit ndaj anëtarëve të këtyre familjeve janë: diskriminimi për sa i përket qasjes në mallra dhe shërbime, diskriminimi i bazuar në gjini dhe të ngjashme.

Përmbajtja e teksteve shkollore është në kundërshtim me Ligjin për familjen i cili garanton barazinë e fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martesë, në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili ndalon diskriminimin bazuar në statusin martesor dhe familjar në arsim dhe natyrisht në kundërshtim me qëllimet e arsimit fillor sipas Ligji për arsimin fillor dhe e drejta për arsimim e çdo fëmije pa diskriminim.

IV. Pjesa Hulumtuese:

IV.1. Metodologjia dhe mjetet metodologjike:

Metodologjia e hulumtimit:

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim bazohet në të dhëna empirike, të cilat përfshijnë kërkime cilësore.

Qëllimi i hulumtimit është i situatës, dhe kjo do të thotë vetëm të tregojë situatën, si një bazë e mjaftueshme për fillimin e një ndryshimi në lidhje me tezën.

Kjo metodologji rrjedh nga analiza e formave të të dhënave të gjalla. Studiuesja mbledh ose bashkë-krijon të dhëna të papërpunuara kërkimore përmes anketave, etnografisë dhe/ose intervistave. Kjo shënon të dhënat me dy cilësi unike që mundësojnë një nivel të integruar të vërtetësisë së të dhënave. Së pari, të dhënat janë të freskëta dhe unike, dhe së dyti, kërkimi është interaktiv. Niveli i vërtetësisë së të dhënave të gjalla është, sipas disa studiuesve, mbase kritik në natyrë, por ai është gjithashtu real dhe bie në kontakt të drejtpërdrejtë me grupin e synuar rreth të cilit u krijua teza. Kjo jep një pasqyrë të drejtpërdrejtë të situatës së grupit të synuar, por gjithashtu përfundimet dhe rekomandimet që dalin në fund, nxirren drejtpërdrejt nga vetë grupi i synuar.

Teknika

Të dhënat u mblodhën përmes intervistave të thelluara gjysmë të strukturuar, përmes takimeve të drejtpërdrejta me të anketuarit, nënat vetushqyese.

Këto të dhëna i shoqëruam me të dhëna sasiore të marra nga pyetësorët online.

Klasifikimi dhe grumbullimi i materialit kërkimor ndryshon nga vlerësimi fillestar për shkak të kushteve epidemiologjike, të paparashikuara, Kovid-19.

Të gjitha nënat vetushqyese u intervistuan përmes ndërveprimit të rrjedhshëm, si në internet dhe ato me intervista të drejtpërdrejta gjysmë të strukturuar.

Për qëllimet e hulumtimit, u krye një hulumtim empirik në formën e intervistave të thelluara gjysmë të strukturuar me nëna vetushqyese të dy fëmijëve nga familje me një prind, nga ku nuk figuron një prind i dytë, nga territori i qytetit të Shkupit. Zgjedhja për metodën e intervistës, pra intervistën gjysmë të strukturuar bëhet në përputhje me natyrën e lëndës së hulumtimit dhe nevojën për ndërveprim.

Shembull

Intervista dhe pyetësi online janë realizuar me mbështetjen e platformës për familjet me një prind të OJQ Njëra Mundet!.

Variabla kryesore në hulumtim, në pyetësin online, iu referua llojeve të ndryshme të familjeve me një prind nga të cilat rrjedhin gratë vetushqyese, ndërsa për intervistat e thelluara, dy nëna vetushqyese u zgjodhën nga familjet me një prind pa atësinë e njohur, pikërisht si një objektiv. një grup i familjeve me një prind, për të cilin shteti nuk ka absolutisht asnjë masë ose mekanizëm për të mundësuar një jetë të mirëqenies dhe paqes.

Mostra nga sondazhi në internet përfshiu nënat vetushqyese nga familjet me një prind:

1. me fëmijë të lindur jashtë martese, me atësinë e njohur,
2. me fëmijë të lindur jashtë martese, me atësi të panjohur,
3. me fëmijë të lindur në martesë i cili është divorcuar në dy vitet e para të martesës,
4. me fëmijë të lindur në një bashkësi me dhunë, ku ka një ndërprerje të bashkësisë, pikërisht për shkak të dhunës,
5. familje me një prind të vetëm të shkakuar nga zhdukja e njërit prind,
6. me familje me një prind të vetëm për shkak të babait që është gjatë vuajtjes së një dënimi me burg,
7. me nënë vetushqyese të ve
8. me nënë vetushqyese e cila themeloi një familje me një prind pasi ajo vendosi të dilte nga një marrëdhënie me një të varur /bixhozxi/alkoolik/ përdorues të drogës dhe substancave psikotrope.

IV.2. Pyetje hulumtuese:

Për këtë qëllim, u krijua një pyetësor i cili u përhap në mënyrë virale dhe i cili u përgjigj nga 241 të anketuar. Ndërsa, për intervistat e thelluara, u përzgjedhën të anketuarit që iu përgjigjën pyetjeve nga intervistat e thelluara, në internet, nga 9, u zgjedhën dy. Nëna vetushqyese maqedonase dhe shqiptare, nga një familje me një prind, pa atësinë e njohur.

Intervistat e thelluara u ndanë në dy segmente pyetjesh, në lidhje me:

- Pyetje që synojnë informacione lidhur me diskriminimin institucional dhe
- Pyetjet që synojnë informacione lidhur me diskriminimin shoqëror.

A. Pyetje që synojnë informacione lidhur me diskriminimin institucional

1. A mendoni se termi prind vetushqyes është i përshtatshëm apo mendoni se duhet të ketë ndryshime në rregulloren ligjore?
2. A Ju ka ofruar shteti ndonjë lloj mbështetjeje gjatë shtatzënisë/lejes së shtatëzanisë?
3. A keni hasur në një situatë që një kërkesë/regjistrim në shkollë të kërkojë vetëm emrin e babait të fëmijës?
4. A Ju ka ofruar shteti ndonjë lehtësim/ndihmë financiare për procesin arsimor të fëmijës tuaj?
5. A keni marrë ndonjë udhëzim nga institucionet në vend lidhur me atë se cilat të drejta Ju takojnë ose aspak?
6. A Ju ka ofruar ndonjëherë shteti t'ju ndihmojë ju dhe fëmijën tuaj në formën e këshillimit social/psikologjik?
7. A mendoni se në vendin tonë familjet me një prind kanë të njëjtat të drejta si kategoritë e tjera të familjes?
8. A keni refuzuar ndonjëherë një vend pune sepse nuk ju është ofruar mundësia e kujdesit adekuat për fëmijën tuaj gjatë kohës që do të kishit qenë në punë?
9. A keni përfituar ndonjëherë një vend pune vetëm sepse jeni nënë vetushqyese?
10. A mendoni se përfitimet për fëmijët nuk duhet të bazohen në fuqinë ekonomike të prindit vetushqyes?
11. A mendoni se Ju, si nënë vetushqyese, duhet të keni ndonjë përfitim financiar?

B. Pyetjet që synojnë informacione lidhur me diskriminimin shoqëror

1. A kishte ndonjë hezitim nga ana juaj, a jeni gati të përballeni me sfidën e “amësisë vetushqyese”? Çfarë dilemash po përballëshiti në atë moment?
2. Si reaguesi të afërmit tuaj kur u treguat se ishit shtatzënë dhe që mendonit të kujdeseni vetëm për fëmijën tuaj?
3. Me çfarë reagimesh nga rrethina jeni përballuar si nënë vetushqyese?
4. Si i shikon nënat vetushqyese dhe fëmijët e tyre shoqëria të cilës ju i përkisni?
5. A është fyer/stigmatizuar/diskriminuar fëmija juaj nga bashkëmoshatarët për shkak se vjen nga një familje me një prind?
6. A jeni ofenduar/stigmatizuar/diskriminuar Jundonjëherë nga fqinjët, bashkëpunëtorët, prindërit e fëmijëve të tjerë vetëm sepse jeni një nënë vetushqyese?
7. Si do ta përshkruanit gjendjen e jetesës tuaj, në lidhje me atë se sa paqe dhe sa shqetësim përjetoni?

Në pyetjen e parë, nga segmenti A. - diskriminimi institucional, **në lidhje me për-shtatshmërinë e termit “prind vetushqyese”**, nëna e parë vetushqyese deklaroi: “Të quhem vetushqyese nga çdo grua tjetër, më pengon shumë, ndihem sikur më mungon diçka, sikur dëshirojnë të më ofendojnë. Nëse, për shembull, më thoshte një nënë tjetër vetushqyese, ajo nuk më shqetëson, sepse unë e di që ajo nuk më fyen por më kupton sepse ajo e di se si është të jesh vetëm me një fëmijë. Termi nuk është i përshtatshëm për mua, nuk do të doja të më thërrisnin sikur të isha dikush me ndonjë mangësi. Ne kemi nevojë për një më të përshtatshme, më të mirë, që të asocion me gjëra më të mira, jo me një mangësi.” Dëshiron që terminologjia të ndryshojë ligjërisht.

Nëna e dytë vetushqyese, shqiptare, iu përgjigj pyetjes së parë në mënyrë të ngjashme me nënën maqedonase. As asaj nuk i pëlqen termi, nuk dëshiron që dikush ta quajë ashtu dhe as nuk e quan veten si të tillë. Sipas saj, është shprehje nënçmuese të jesh prind vetushqyese. Ajo dëshiron të jetë nënë, e zakonshme, si të gjithë, por që kujdeset për fëmijën e saj vetëm. “Vetushqyese” nuk tingëllon bukur, sikur të nënkuptojë “e keqe”, ndihet si një grua e “e papastër” nëse dikush e thërret ashtu. Është e kotë ta shkruash edhe në Ligj si vetushqyese, nuk do ta dëshiroja këtë, megjithëse nuk ka term më të përshtatshëm për të sugjeruar. Sido që të jetë, është e rëndësishme të mos të të bëjë të ndihesh keq.

Pyetjes së dytë, **“A iu ofroi shteti një lloj mbështetjeje gjatë shtatëzënisë?”** si nëna vetushqyese, të dyja u përgjigjën negativisht. As shteti nuk ka ofruar ndihmë dhe as ndonjë lloj tjetër të mbështetjes.

Nëna e parë, ka kërkuar ndihmë të përhershme financiare, për të cilën është informuar përmes platformës së organizatës së shoqërisë civile për promovimin e të drejtave të prindërve vetushqyzez, Njëra mundet!. Që aty, ata e ndihmuan në mbledhjen dhe dorëzimin e dokumenteve për një masë që ata e konsideruan të zbatueshme, një masë për ndihmë të përhershme financiare, e cila u referohet personave me status të rrezikuar social, nënave vetushqyese të papuna me fëmijë deri në moshën tre vjeçare. Masa nuk u refuzua, por nuk u shpërnda, ashtu si është shkruar në rregulloren për përdorimin e masës në fjalë, sepse të drejtën e përdorimit e përfiton një nënë vetushqyese nga muaji i 9-të i shtatzënisë.

Kjo mospërputhje është vërejtur nga organizata Njëra Mundet!, përmes raportimeve nga anëtarët, në disa raste.

Nëna e dytë vetushqyese, shqiptare, nuk e dinte që ekzistonte ndonjë mundësi e tillë, ajo nuk kishte asnjë informacion dhe nuk mendonte se mund të merrte diçka nga shteti, e as që i takonte.

Ky besim se “nuk ju takon” shfaqet si një dëshmi për shumë nëna vetushqyese me të cilat studiuesja bie në kontakt, dhe për këtë arsye tregon se është problematike dhe ka nevojë për kërkime të mëtejshme

Lidhur me pyetjen e tretë: **“A keni hasur në një situatë që një kërkesë/regjistrim në shkollë të kërkojë vetëm emrin e babait të fëmijës?”**, e anketuara e parë dhe e dytë janë përballur me situata ku kërkohej emri i babait. Të dy të anketuarat kanë refuzuar të shkruajnë emrin e babait dhe janë nënshkruar vetëm. Lidhur me këtë pyetje, të dy të anketuarat kanë përvoja të dhimbshme dhe të vështira. Fillimisht për shkak të një momenti të konfrontimit të drejtpërdrejtë me faktin se nuk ka baba në familjen e tyre, dhe së dyti për shkak të fëmijëve. Që të dy e kujtojnë këtë si momentet e pikëllimit më të thellë. E anketuara e parë theksoi që: “Edhe lotët edhe zemërimi dhe hidhërimi, të gjitha bashkohen dhe njeriu nuk mund të përmbahet. E sidomos në momentet kur fëmijët janë të pranishëm dhe ju shikojnë në sy ... dhimbje, dhimbje e madhe, sikur trupi të del nga vetvetja sepse nuk mund të durojë”.

E anketuara e dytë mendon se “nëse babai nuk dëshiron të qëndrojë në certifikatën e lindjes së fëmijëve të tij, nuk mund të bëj asgjë. Unë do të qëndroj aty për ta, kudo që të jem e nevojshme. Është turpi atij, ai është vetushqyese sepse nuk i do fëmijët e tij, jo unë”.

Për pyetjen e katërt, **lidhur me lehtësimin financiar ose mbështetjen në procesin arsimor të fëmijëve**, të dyja pajtohen se shteti nuk ka asnjë mundësi.

E anketuara e parë, me fëmijën më të madh, nuk ka shfrytëzuar ndonjë lehtësim financiar, dhe as nuk ka marrë ndonjë përjashtim gjatë arsimit parashkollor ose në shkollën fillore, përveç gjatë periudhës kur ajo ishte pa punë, kështu që siç thotë ajo “... mësuesi i klasës i organizoi ata prindërit, për të mbledhur fonde për 4 muaj “në mënyrë që fëmija i saj të mund të përdorë kuzhinën e shkollës, dhe të hajë me të gjithë fëmijët e tjerë. Për sa i përket shpenzimeve të shkollës së mesme, nuk ka asnjë lloj mbështetje shtetërore as edhe për shkollat e mesme profesionale. Ajo thotë se kanë shpenzime javore për shkollën si miqtë e tyre të

shkollës së mesme, për shembull, të cilat nuk i kanë as në baza mujore. Ky shpenzim shtesë nuk mbulohet nga askush, aq më pak nga shteti.

E anketuara e dytë thotë se ajo gjithashtu kurrë nuk ka marrë ndonjë mbështetje financiare ose lehtësim, deri më tani, nga shteti për procesin arsimor të fëmijëve. Është interesant fakti, i cili tregon një mosrespektim të plotë ligjor, dhe thotë: “Sepse isha e papunë, nuk pata mundësinë ta regjistroja fëmijën në kopsht, dhe isha në listën e pritjes gjatë gjithë kohës, derisa fëmija mbushi pesë vjeç. Kurrë nuk kam arritur të vij në rradhë për të shkuar në kopsht, për shkak të mungesës së formularëve M1 dhe M2. Formularët mund të merren vetëm nëse jeni e punësuar, ndërsa nëse fëmija juaj nuk pranohet në kopsht, nuk mund të punësohesh.” Tani, nga ky vit, ajo përdor lirimin nga participimi në kopsht për fëmijën më të vogël, si përfituese e një page më të ulët se paga mesatare në vend.

Pyetja e pestë, **“A keni marrë ndonjë udhëzim nga institucionet në vend se cilat të drejta i ju takojnë?”** të dya të anketuarat sqaruan se “asnjëherë nuk kanë marrë asnjë lloj informacioni, se nuk ka ndonjë institucion ku ata mund të drejtohen, se edhe në shërbimet sociale ku që të dya në periudha të caktuara të jetës iu drejtuan, ata nuk dinin se ku të drejtoheshin, duke i treguar të anketuarës së parë se “nuk ka vend për të aty, nëse ajo ka prindër të gjallë dhe ata duhet ta ndihmojnë atë në kujdesin e saj për fëmijët, sipas ligjit”. Ndërsa me të anketuarën e dytë, në vizitën e parë tek shërbimet sociale, ku i janë përgjigjur se “atje nuk ka arsye për të kërkuar të drejta, le të kërkojë ndihmë nga babai i fëmijëve”. Dhe gjatë vizitës së dytë, ajo tregon se u shfaq e përgatitur, duke ditur të drejtat e saj dhe me një kërkesë specifike për ushtrimin e së drejtës për të kërkuar ndihmë për shtesa fëmijërore dhe shkollë, për të cilën u dorëzuan dokumentet më të rregullta për aplikim, por fatkeqësisht akoma edhe pas 6 muajsh nga paraqitja nuk mori asnjë përgjigje, as pozitive dhe as negative.

Pyetja e gjashtë **“A Ju ka ofruar ndonjëherë shteti t’ju ndihmojë ju dhe fëmijën tuaj në formën e këshillimit social/psikologjik?”** është një pyetje që të dy të anketuarat u përgjigjën sikur të ishin marrë vesh më parë, jo, megjithëse në kohë të caktuara ka qenë më se e nevojshme që ata të merrnin këtë lloj mbështetjeje. Ata nuk kanë patur një mbështetje të tillë, në të dya rastet dhe nuk ishin të vetëdijshme se kanë nevojë për një mbështetje të tillë. Kur filluan të bëhen pjesë e një platforme për nënat vetushqyese, ata panë që disa nga gratë po punonin me veten e tyre në këtë mënyrë, përmes këshillimit dhe udhëzimit psikoterapeutik. Fatkeqësisht, të dya ata deklarojnë se nuk kanë mundësi financiare për të siguruar këtë lloj mbështetjeje vazhdimisht. Nëna e parë aludon në nevojën për këtë mbështetje, veçanërisht “kur fëmijët hyjnë në faza të ndryshme, për të cilat gjithashtu duhet të përgatiteni më thellësisht”.

„A keni refuzuar ndonjëherë një vend pune sepse nuk ju është ofruar mundësia e kujdesit adekuat për fëmijën tuaj gjatë kohës që do të kishit qenë në punë?,” për këtë pyetje, e anketuara e parë thotë: “Ehee, edhe të njohurit më refuzuan për një punë që e dinin se isha e aftë, edhe më e aftë se ata, sepse isha gjithmonë isha e sinqertë dhe pranoja se nuk është e lehtë për mua të jem vetëm me fëmijë. Menjëherë, si rrjedhim, ata ju shohin si një per-

son jo-punëtor, sikur nuk do të jeni në gjendje të merreni me punën, sepse keni fëmijë për të cilët kujdeseni vetë. Derisa gjeta mundësi për tu vetëpunësuar, vrapova nga një punë në tjetrën, të cilat natyrisht i gjeja vetëm dhe kaloja më mirë me punëdhënësit që nuk i njihja se sa me ato të njohur. Kam përjetuar gjithçka, nga intervistat për punë, deri tek propozimet e pahijshme, te kërkesat për të qëndruar jashtë orarit të punës dhe për të qenë një pastruese më shumë se një punëtoare intelektuale. Diskriminim, fyerje, direkte dhe indirekte ... askush thjesht nuk ju mbron, aq më pak shteti.”

E anketuara e dytë në lidhje me këtë pyetje, e bëri të qartë se ajo ishte një “amvise e detyruar” sepse nuk ia pranojnë fëmijën e saj në kopsht, derisa të fillojë në shkollë. Pasi fëmija filloi me shkollën, ajo ndërroi 4 vende pune derisa gjeti punën stabile që e ka edhe sot, thotë ajo. Ajo nuk dëshiron të komentojë përpjekjet e mëparshme për punë, sepse siç thotë ajo “nuk ia vlen të komentohen, të gjithë sillen ashtu si duan me ty kur je grua dhe kur zbulojnë se je vetëm me fëmijë, sikur të jesh një shtëpi pa derë”. Pas katër përvojave negative, pozicioni i saj aktual i punës është i sigurt, i qëndrueshëm dhe ajo është e kënaqur edhe pse nuk ka vend për avancim profesional, rritje të pagave dhe mësim të gjërave të reja. “Të paktën është një punë e sigurt nëse asgjë tjetër,” tha ajo.

Pyetja e nëntë ndërlidhet nga e teta dhe po, të dy të anketuarat nuk kanë përfituar ndonjë vend pune të caktuar për shkak të faktit se ato janë nëna vetushqyese, siç përmendet në kontekstin e disa prej përgjigjeve të mësipërme. Shteti nuk i ka mbrojtur kurrë për këtë shkak, ata nuk dinë se si ta bëjnë

Pyetja e dhjetë, „ **A mendoni se përfitimet për fëmijët nuk duhet të bazohen në fuqinë ekonomike të prindit vetushqyese?**” u sqarua më tej në kuptimin që sipas madhësisë së të ardhurave mujore të nënës duhet të përcaktohen dhe të përpilohen masat e mundshme: lirimet, përfitimet, shtesat financiare dhe materiale ose të ngjashme. Për këtë pyetje, të dy ranë dakord që do të duhej të ishte ashtu, do të ishte më e drejta për të gjithë. Për shembull, nëse ka nëna me të ardhura minimale, ato duhet të marrin, të themi, një shtesë të plotë për fëmijë, dhe ato me të ardhura mesatare duhet të marrin një gjysmë shtesë për fëmijë, ndërsa ato me të ardhura mbi mesataren mund të kenë një ndihmë minimale prej një të tretës të shtesës së plotë. Sigurisht që duhet të ketë më shumë shtesa të tilla, veçanërisht për të papunët dhe ato nëna të fëmijëve të vegjël ose edhe më shumë për nënat vetushqyese të fëmijësh me nevoja të veçanta.

Ndjeshmëria që të dy të anketuarat shprehën në lidhje me këtë pyetje, ishte e nevojshme të evidentohet në këtë rast studimi, sepse të dy folën për pozicione në të cilat të dy nuk kanë qenë/nuk janë, nuk janë sot, gjatë realizimit të intervistave. Ata nuk ishin nëna vetushqyese të fëmijëve me nevoja të veçanta, por kanë përjetuar shumë që në fillim të vetëamësisë, si nëna të reja të papuna të fëmijëve të vegjël dhe padyshim që kjo ka lënë gjurmë të thella tek të dy, dhe sot ata i kuptojnë nënat e tjera në pozicione të ngjashme. Pyetja e fundit, mbi diskriminimin institucional, kryesisht përmes mosnjohjes së politikave dhe masave për grupin e synuar, „**A mendoni se Ju, si nënë vetushqyese, duhet të keni ndonjë përfitim financiar?**“, të dy thanë “patjetër që po”. E anketuara e parë foli rreth asaj se sa më lehtë do të ishte për të nëse do të kishte ndonjë mbështetje, duke marrë parasysh faktin se askush nuk e ndihmon përveç vetes së saj, as financiarisht, as teknikisht dhe praktikisht. Në familjet ku figuron njëri prind në çertifikatën e lindjes së fëmijëve, nuk ka mundësi për alimention dhe nëse të dy gjyshërit nuk janë ekonomikisht të fuqishëm dhe/ose “nuk e ndiejnë këtë lloj përgjegjësie, për të ndihmuar vajzën dhe nipërit/mbesat e tyre, askush nuk mund t’i detyrojë për t’a bërë këtë”. Ky informacion u konfirmua nga e anketuara e dytë, e cili tha: “Ishte e qartë për mua se çfarë më ngeli që në fillim, nuk e ndiej që kam shtet dhe familja ime më refuzoi për shkak të hapit që vendosa të ndërmarr. Unë nuk kam ndihmë financiare nga askush, të gjithë jetojmë me pagën time, të cilën për fat të mirë e kam rregullisht vitet e fundit, më parë ishte një tmerr. Do të ishte shumë mirë të merrnim mbështetje financiare nga shteti.”

Të gjitha njëmbëdhjetë pyetjet në lidhje me diskriminimin institucional përmes mosnjohjes së politikave dhe masave për grupin e synuar, të dy të anketuarat tregojnë një nevojë reale për mbështetje, përmes të gjitha pyetjeve, veçanërisht në lidhje me mbështetjen në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.

Nevoja është më e madhe për mbështetje financiare ndërsa fëmijët rriten.

Poashtu janë vërejtur pamundësi edhe për të hyrë në tregun e punës.

Në segmentin e dytë, B. pyetjet që synojnë diskriminimin shoqëror, ka 7 pyetje, për të cilat u organizua një kohë e veçantë për intervistim me të dy nënat, për shkak të nevojës së madhe për të shpjeguar segmente të caktuara që i prekën ato thellësisht.

C. Çështje që synojnë diskriminimin shoqëror

1. A kishte ndonjë hezitim nga ana juaj për atë se a jeni të gatshme të ballafaqoheni me sfidën e “amësisë vetëushqyese”? Me çfarë dilemash ballafaqoheni në atë moment?

E anketuara e parë thotë: “Në fillim dhe shumë pas kësaj, kishte hezitim, dhe edhe pasi e mora ven dimin, nuk je e qetë. Nuk është aq e thjeshtë, vazhdimisht e pyet veten nëse e ke marrë vendimin e duhur, nëse do të kishte qenë më mirë nëse do të kishe marrë vendimin e kundërt, a ke gabuar, ku ke gabuar ... Dilemat gjatë marrjes së vendimit ishin në drejtim të asaj që është etikisht korrekte, çfarë është njerëzisht e drejtë, nëse si grua e dua këtë lloj amësie dhe nëse fëmija ka të drejtë të lindë në një familje të zakonshme apo do të ishte mirë për të dhe në një familje vetëm me nënën.

Dilemat pas marrjes të vendimit shkonin nga ajo se a do të mund të duroja fizikisht, psikikisht, mendërisht dhe natyrisht financiarisht. Disa nga dilemat ishin reale për mua, sepse e dija në çfarë shoqërie të parregulluar vendosa për një hap të këtillë të pazakontë, disa nga dilemat më lindën frikën, kurse disa ishin nga ndikimi i të tjerëve me të cilët kontaktoja atë periudhë.”

Nëna e dytë vetëushqyese tha se dilemat ekzistojnë edhe sot, dhe se i ka pasur më intenzive në periudhën kur duhej të merrte vendimin. Megjithatë, në fund është ka vendosur të mbledhë guxim dhe të kujdeset për fëmijën më pas për fëmijët, pak më ndryshe nga nënat e tjera. Sidoqoftë, ajo thotë se edhe pse ka krijuar tregime të ndryshme në kokë, ata të realitetit e kanë tronditur, dhe sinqerisht nuk ka pritur se duhej të përballej me gjithë ato, dhe as nuk ka menduar se nëse vjen në situatë të përballet, do të durojë, do të gjejë forcë.

2. Si reaguesi të afërmit tuaj kur u treguat se jeni shtatzënë dhe se mendoni që vetë të kujdeseni për fëmijën tuaj?”

Kësaj pyetje nëna e parë vetëushqyese ka marrë komente të ndryshme, ndër të cilat rrallë është gjindur ndonjë për përkrahje. Shumica e njerëzve kanë reaguar të frikësuar, të befasisur, të habitur edhe shpesh e kanë dënuar. Ajo thotë: “Nëse kthehesh rreth vetes dhe u jep një lajm të tillë, për të sjellë jetë të re të afërmit tuaj, së paku pret që të të urojnë të gjitha të mirat. Në rastin tim nuk ishte ashtu. Shikoja vetëm dënim në sytë e tyre.” Edhe kjo e anketuar shton se këta kujtime janë përvojë e dhimbshme për të, se e kanë larguar nga njerëzit që deri atëherë ka qenë e afërt, sepse ka pritur mirëkuptim dhe pranim të vendimit të saj. Në periudhë të caktuar të jetës, ka qenë shumë e vetmuar për shkak të kësaj dhe thotë: “Në momente ndihesh aq e vetmuar, sikur e gjithë bota të dënon për shkak të vendimit të pazakontë, me çka megjithatë bën një hap altruist, sipas meje. Mbi të gjitha bëhet fjalë për lindjen e një fëmije.”

E anketuara e dytë ka pasur përvojë më intenzive rreth situatës në bazë të kësaj çështje. Në rastin e saj ka pasur edhe situatë ku familja më e afërt pa e pyetur i ka caktuar termin për abortim. Me dhunë kanë dashur ta dërgojnë të abortojë, por me përplasje fizike disi ka ar-

ritur ta shmangë atë akt të padëshiruar. Pas kësaj, ajo ka qenë edhe më e vendosur të mos devojë nga ajo që e ndiente “se duhet ta sjellë në jetë atë fëmijë, si që i thot zemra”, t’u shmanget atyre që e detyrojnë të dyshojë në vendimin e vetë dhe të vazhdojë tërësisht vetëm. “Kupton se nuk ke pasur asnjëherë të afërm, se ajo ka qenë familje në dukje, derisa luan sipas rregullave të tyre dhe ndihmon, aty je për ata. Kur duhet të jesh aty për vete, kupton se nuk ke askënd.”

3. Me çfarë reagimesh përballeni nga komuniteti si nënë vetëushqyese?

“Komuniteti, si edhe familja dhe familja më e gjerë, nuk më përkrahnin shumë. Nëna e parë shprehet se ajo ka zhvilluar një pakënaqësi të veçantë në lidhje me mospranimin e situatës së saj nga familja e saj e ngushtë dhe e gjerë por edhe nga miqtë e saj. Thotë se “mund ti numërojë në gishta njerëzit që i ka njohur gjatë gjithë jetës dhe që janë gëzuar për lajmin e foshnjës. Të gjithë, më shumë se 90%, e kanë dënuan ashpër dhe ose ajo vetë është tërhequr nga ato marrëdhënie, ose aq shumë janë ofenduar edhe ajo edhe pala tjetër sa që ata thjesht janë larguar nga jetëte tyre. Është për tu habitur që disa nga të tjerët, me të cilët kontaktet përfunduan në një farë mënyre, ia lejuan vetes të mos e praninin vendimin e saj, i cili në fund të ditës është “zgjidhje individuale”.

Sidoqoftë, ka pasur dhe ka komente të tilla si: “Respekt, ne të dy nuk mund të vendosim për një hap të tillë kurse ti vetëm. Të lumtë!”

Nëna e dytë thotë se fillimi gjithashtu ka qenë më i ndërlikuar, për sa i përket reagimeve të komunitetit, ndërsa sot, të gjithë e urojnë për guximin, këmbënguljen, përkushtimin e saj ... mirë është të dëgjosh se je supernënë, por disa herë vërtet është e vështirë dhe nevojitet mbështetja që në realitet nuk ekziston “. “Më shumë është për tu habitur se si disa njerëz thonë gjëra që janë larg nga e vërteta, që unë jam kështu, ashtu, ... vënë në dyshim moralin dhe nderin, dhe nuk mendojnë se ato të pavërteta do të arrijnë edhe tek fëmijët, por mbase as që mërzhiten për këtë. Kurse të tjerët më shohin si një supernënë, që nuk është edhe bash ashtu, veçanërisht kur dikush prej nesh në shtëpi është sëmurë, dhe nuk kemi ndihmë as përkrahje, kur duhet të shkohet në udhëtim, në pushim, kur janë festa ... të gjitha ato ditë ato janë të vështira për ne, nëse tek familjet e tjera janë të lumtura. “Aty, në ato ditë, sheh sa je vetëm me fëmijët dhe sa të gjitha bisedat janë të pavlefshme, as të mirat dhe as të këqijat”.

4. Si komuniteti të cilit i përkisni i sheh nënat vetëushqyese edhe fëmijët e tyre?

“Si komunitet që është shumicë në vend, nuk mendoj se ne, maqedonasit, jemi disi veçanërisht të shtypur, por si mjedis të themi ballkanik me atë mentalitet, mendoj se jemi radikalë në tema të këtilla, që ne bëjmë thashetheme dhe bëjmë pyetje private që për shembull, në Amerikë ose Angli, Gjermani, asnjëherë nuk do t’ia kishin parashtruar njëra tjetrës. Kam një ngjarje, dua ta ndaj: Unë dhe djali im ishim duke shëtitur në Ohër me pushime, pyeta një xhaxha dhe gruan e tij që ishin duke e prerë gardhin e tyre në oborr, edhe sa ka deri te stationi i autobusëve. Ata mu përgjigjën edhe më pyetën a jam prej këtu. U thashë jo, jemi nga Shkupi. Më pyesin nëse burrin e kam nga Shkupi? U thash se nuk jam e martuar. Të habitur

qëndruan për disa sekonda më pas më pyetën, nëse nuk jam e martuar, atëherë i kujt është fëmija? “Ky është një nga shembujt e shumtë që kam hasur dhe bash nga askund, nga njerëz të rastësishëm por edhe nga njerëz të afërt nga të cilët pret mirëkuptim.”

Me të anketuarën e dytë, biseda për komunitetin që ata i përkisnin ishte pak më intensive dhe nëse nëna e parë me shaka na tregonte për të gjitha paragjykimet kulturore me të cilat përballej si nënë vetëushqyese, atmosfera këtu ishte ndryshe.

“Tek ne, kur lind një fëmijë femër, thuhet se edhe trarët qajnë”. Kur u bëra nënë vetëushqyese e kuptova që kjo është një e vërtetë shumë e madhe. Një baba nuk është përballur kurrë me këto gjëra me të cilat unë si grua përballem. Gjëja e parë që duhej të bëja ishte të largohesha nga komuniteti që njihja dhe dija, sepse u refuzova, nuk më pranuan. Me fëmijën e parë më detyronin të abortoja, por disi, edhe nga turpi nga fqinjët e mi, më pranuan, edhe pse vazhdimisht më kujtonin turpin që ua kisha bërë. Me fëmijën e dytë, jo vetëm që më refuzuan plotësisht, por edhe më ndëshkuan për turpin që ua bëra. Kisha një propozim martesë për jashtë vendit, me një beqar, por shumë, shumë më të vjetër, në mënyrë që të mos rrija këtu që fqinjët e mi të më shihnin vetëm me dy fëmijët e mi dhe ashtu ti turpëroj. Por unë gjithmonë kam qenë nga më zë zgjuarit, kam mësuar, jam munduar shumë, kam shkuar në trajnime dhe kam punuar. Dhe kjo ishte e çuditshme për komunitetin që i përkas, por disi më flisnin nëpër dhëmbë. Tani me këto situata me fëmijët, u derdh gota. Edhe pse të gjithë e dinin që unë nuk isha tamam si ata, prapë më dënuan shumë. “Ndonjëherë, kur ishim shumë të varfër, na ndihmonin fqinjët e rinj, të panjohur, por kjo ishte kur tanët na dëbuan disi, kur isha vetëm me një fëmijë dhe një foshnjë të vogël dhe nuk mund të punoja”. Megjithatë, e anketuara jonë e dytë mendon se ajo nuk është zgjidhje, të presësh fqinjët kur të kujtojen, por është e lumtur që ka pasur nga ata që janë kujtuar, pak a shumë.

5. A është ofenduar / stigmatizuar / diskriminuar fëmija juaj ndonjë herë nga bashkëmoshatarët e vetë për shkak se vjen nga një familje me një prind?

Tek e anketuara e parë, fëmijët nuk janë ofenduar nga bashkëmoshatarët e tyre për shkak të familjes me një prind nga vijnë. Ajo theksin e vëndon tek ofendimet nga ana e familjes së gjerë, nga ku, pavarësisht për çfarë problemi të gjerë familjar bëhet fjalë, gjithmonë e shohin statusin e familjes së saj me një prind si rrënjën e problemit. Kurse nuk kishte ofendime më konkrete, veçanërisht nga bashkëmoshatarët.

E anketuara e dytë gjithashtu deklaroi se nuk ka pasur diskriminim më të madh, përveç një herë me fëmijën më të madh, kur fëmijët e fqinjëve së pari e kanë pyetur se ku është babai i tyre dhe më vonë kanë brohoritur “nuk ka baba, nuk ka baba”. Ky problem është zgjidhur nga të rriturit, dhe që atëherë ata nuk kanë pasur situata të ngjashme. Diskriminimi buron më shumë edhe në këtë rast, nga familjet origjinale të të anketuarve dhe janë ndaj fëmijëve. Të dyja theksojnë problemin me librat shkollorë, ku kërkojnë të vendosen fotografi të dasmave, ku përkufizimi i një familje është: “prindërit dhe fëmijët krijojnë një familje”, kështu që fëmijët hyjnë në shpjegime, çfarë është familje, kush ka dhe kush nuk ka familje.

6. A jeni ofenduar / stigmatizuar / diskriminuar ndonjëherë nga fqinjët, bashkëpunëtorët, prindërit e fëmijëve të tjerë vetëm pse jeni nënë vetëushqyese?

E anketuara e parë nuk ka detektuar diskriminim të drejtpërdrejtë, ndërsa indirekt ndihej e ofenduar në disa raste, në mënyrë të përsëritur gjatë viteve. Ajo tregon shembullin e saj të shpeshtë, i cili e shqetëson: “Për shembull, habitem shumë dhe si tu përshkruaj diagnozë në kokë, për gratë që janë të martuara dhe që ndajnë gjithçka me mua, më thonë se burri është barrë shtesë dhe sa e vështirë është për ata, më e vështirë mua vetëm me fëmijët, sepse ja edhe për burrin kujdesen kurse ai nuk ndihmon azgjë. Kjo mua më vjen sikur dikush i ka mësuar t’u thonë kështu grave që janë të vetme me fëmijë. Gjithashtu interesante për mua është, kur gra që i njoh, të cilët janë vetëm dhe të lira, pa fëmijë, me ose pa partnerë, disa jetojnë tërësisht vetëm, disa jetojnë edhe me prindërit e tyre, më thonë se nuk kanë kohë dhe se janë të lodhura. A janë serioze, gjithmonë pyes veten. Në situata të tilla ndihem nuk e di nëse diskriminohem, por sikur më shohin si budallaqe, sikur nuk e kuptoj që flasim sa për sy e faqe. Nëse unë vetëm me fëmijët, kujdesem për shtëpinë, dhe për çdo vakt të mundshëm, laj fëmijët, vesh, hekuros, laj, bëj pazarin, mbaj, fitoj, dërgoj dhe marr fëmijë nga kurse dhe sporte, përpiqem të ndërtoj një karrierë sinqerisht dhe mezi arrij të kreh flokët, dhe nuk ankohem, nuk has në mirëkuptim kur lodhem nga të gjitha çdo ditë të javës e kështu për vite me radhë. Unë nuk i kuptoj të tjerët kur ata nuk marrin parasysh jetën që ne vetëushqyestet e jetojmë dhe na gjejnë ne të na ankohen për jetën e tyre. Unë ato gjëra i shoh si ofendim, si mungesë ndjenje, si poshtërim ...”

E anketuara e dytë deklaroi se e sheh diskriminim në rastin e saj në fusha të ndryshme, kështu që për disa vjet ajo kërkoi një punë ku nuk do të abuzohej, kështu që është shpërngulur derisa ka gjetur një vend të qetë për të jetuar për veten dhe fëmijët e saj, ku nuk do ta sulmojnë, nuk do të bëjnë thashetheme për të dhe nuk do ta gjykojnë. Ajo thotë: “Në disa raste për shembull, në punët të cilat i kam punuar më parë, u pengonte që sepse e dijnë se jam vetëm me dy fëmijë sepse mendonin se nuk jam e ndershme. Në një punë tjetër, mendonin se për shkak se unë punoj shumë në shtëpi, si nënë e vetme, nuk do të kisha forcën për të punuar në punë. Në një rast tjetër, ata më shihnin si një person të thjeshtë, sepse situatat në jetën time më ndodhën të isha vetëm me dy fëmijë, kështu që nuk më besonin punë me përgjegjësi dhe më detyronin të bëja vetëm punë fizike, sepse besonin se nuk isha e aftë. Kam pasur raste të ndryshme, por nuk jam dorëzuar. Nuk kam harruar asnjë nga fyerjet, poshtërimet, pasiguritë që më imponuan dhe sa e vështirë është të jetosh me gjithë atë. Duke kaluar vitet, e kam më të qartë se nuk ka asnjë lidhje me mua, por si e re fajësoja veten, pyesja veten pse më ndodh e gjithë kjo ... nuk e doja veten, nuk dija si. Tani kur i shoh fëmijët, së pari mësova t’u tregoj atyre se si të duan njëri-tjetrin, të mos jenë si isha unë. “Dhe pa marrë parasysh sa i ofendojnë jashtë, të dinë të duan njëri-tjetrin dhe të mos pranojnë gjëra të këqija nga njerëzit”.

Dy të anketuarat aluduan në situata të ngjashme, pavarësisht nga fakti se perceptimet e njëra-tjetrës në lidhje me diskriminimin nuk ishin të barabarta.

Është e rëndësishme që të dyja, në nivel emocional janë të vetëdijshëm dhe të dinë të njohin kur përjetojnë diskriminim.

Mbizotëron diskriminimi dhe ngacmimi i drejtpërdrejtë, si dhe diskriminimi kryesisht indirekt dhe ulja e ndjenjës së vetëvlerësimit.

7. Si do ta përshkruanit situatën e jetës tuaj, në lidhje me atë se sa paqe dhe sa shqetësim jetoni? Si i kontribuoni paqes tuaj personale dhe a keni vërejtur situata kur nga jashtë ju sigurohet ndonjë kusht që kontribuon në paqe?

Sa i përket kësaj pyetje të anketuarat ishin emotive dhe përderisa e para u mendua para se të përgjigjet, e dyta qeshi.

“A jetoni në paqe?” E anketuara e parë më pyeti. Nuk priti për një përgjigje dhe tha: “Në pak më pak se 40 vitet e mia, unë njoh një paqe, paqen që fëmijët e mi janë të shëndetshëm dhe të gjallë. Çdo gjë tjetër që jetoj është e shqetësi. Lufta për ekzistencë. Kjo nuk është shoqëri, kjo është xhungël dhe ne nuk kemi shtet që të na mbrojë. Në të gjitha rastet kur jam përprekur të raportoj, qoftë dhuna, mobingu, qoftë nëse kërkoja ndihmë kur më duhej, kam hasur në dyer të mbyllura. Në çdo situatë ku prisja të paktën një dorë njerëzore të zgjatur, nuk e kam pasur. Gjithçka që unë di dhe kam mësuar këtu është e shqetësim. Pse lufton gjatë ditës për të mbijetuar dhe në shtëpi lufton për të qenë dy dhe për t’i çuar fëmijët në rrugën e duhur. Në mbrëmje mundohesh të flesh gjumë dhe më pas të mos kesh makthe nga jeta e përditshme. Unë nuk di për paqen, nuk kam parë paqe dhe as nuk mendoj se shoqëria kontribuon që ne të jemi të paktën pak të qetë. Vetëm ajo që bëj për tu qetësuar është të këndoj këngë në kokën time. Dhe i përsëris vargjet si një shirit i prishur që të mos çmendem, në mënyrë që të mos mendoj më për fatkeqësinë me të cilën ballafaqohem. Që të mund të flas e qetë me fëmijët, në mënyrë që të mos përçoj ta imazhin e realitetit dhe në mënyrë që t’i rris dhe edukoj ata me dashuri. Ndonjëherë ndihem si në shfaqje, ndonjëherë besoj në atë që u them, se gjithçka do të jetë mirë. Por në mëngjes përballlem me një pengesë të re, është e vështirë të përgatitësh dy fëmijë vetëm dhe të dalësh për t’i çuar në kopsht, shkollë, për të arritur në kohë për në punë. Askush të mos harrojë asgjë, ti të paktën të jesh e krehur. Mandej të jenë gati me detyra shtëpie, të pastër, pa njolla, të mos harrosh as gomë e as laps, të jenë të gatshëm psikikisht dhe emocionalisht për në shkollë, jo vetëm fizikisht. Për mua më së paku mbetet kohë. Mua asnjëherë nuk ka pasur njeri që të më pyeste nëse jam gati. E kam pasur patjetër të jem gati. “Çfarë lloj paqeje është ajo?”

E anketuara e dytë thotë: “Më duket qesharake pyetja dhe më duket e çuditshme që është pjesë e kësaj interviste. Me kalimin e viteve, unë kam mësuar të eci me një buzëqeshje në fytyrë, pjesërisht për shkak të fëmijëve dhe pjesërisht sepse nuk dua të dorëzohem para

njerëzve. Nuk dua që disa të kënaqen me mua dhe të tjerëve t'u vie keq. Jam e qetë vetëm kur arrij t'i çoj në shtrat të larë dhe të ushqyer, vetëm atëherë më zë gjumi të qetë. Por për të arritur tek ajo ... shpirti im e di. Unë dua të jem e mirë në punë, ta bëj punën me ndershmëri dhe e bëj atë. Sapo të nisem për në shtëpi e di që jam e lodhur, por e qetë që kam mbaruar përgjegjësitë e mia të punës. Por nuk mund të pushoj sepse më duhet të bëj pazarin, ku ka zbritje që është ecje shtesë këndeje e andej. Më duhet të organizoj blerjet në mënyrë që të mbuloj të gjitha shpenzimet që kemi. Qira, fatura shtëpie, fatura shkollore, ushqim dhe veshje ... kur duhet të paguajmë ilaçe është më e vështira për mua. Atëherë më vret ndërgjegja dhe kam shqetësimin më të madh ... Unë mendoj se nëse do të blija ushqim më të shëndetshëm do të sëmureshim më pak, dhe e di që nuk mund të siguroj gjithmonë ushqimin më të shëndetshëm. Ne duhet të hamë shpesh dhe gjëra të zakonshme, makarona, tarana, petë, kiflet dhe petulla, për të mbijetuar deri në fund të muajit. Ky është shqetësimi im më i madh. Shpesh sëmuremi sepse gjithçka nuk arrihet vetëm. Kur marr fëmijët dhe kthehemi në shtëpi të ngarkuar, më pret gatimi, lutje për ushqim, larje enësh, detyra shtëpie dhe lexim, pastaj diskutim për të mësuar, të sistemojnë pas vetes, të nxjerrësh qenushin jashtë, të pastrohet, të balancohet në mënyrë që të mos ketë grindje...

Dhe ne nuk kemi asnjë ndihmë, asnjë fond nga asnjëra palë. Vetëm një pagë për gjithçka. Ky është shqetësimi im. Si t'i paguaj të gjitha faturat dhe të kursej për të dërguar fëmijët në pushime të paktën një herë në vit, si të paguajnë për një gjuhë të huaj, si të paguajnë për sport dhe të arrij t'i ushqej shëndetshëm ... Kështu kur flasim, shoh se nevojave të miya si femër asnjëherë nuk u ka ardhur rradha. Vitet e fundit, si nënë vetëushqyese, nuk kam të drejtë për dëshira dhe nevoja personale. Unë madje nuk e di se çfarë më mungon më, çfarë do të doja, çfarë më duhej. E di që nuk kam dhe nuk mund t'ia lejoj vetes asgjë. Dhe se do të mbetet kështu derisa fëmijët të fillojnë të fitojnë për veten e tyre. Kurse deri atje kemi edhe shumë. Atëherë do të vijë pleqëria, pastaj nipërit e mbesat, pastaj sëmundjet dhe ilaçet... kush e di se çfarë na pret. Si mund të flas për paqen, me këtë që jetojmë? Çfarë paqeje? Çfarë është paqja? Si mund të kontribuoj për paqen? Unë kontribuoj për mbijetesë çdo ditë, kjo është një luftë për mbijetesë. Do ta them përsëri, mendova se do të ishte e vështirë, por njerëzore. Nuk mund ta merrja me mend se kjo do të ishte dhe do të mbetej. Se nuk ndalet. Se çdo ditë zgjohesh dhe futesh në një daulle në të cilën nuk ka kush të të zëvendësojë. Por ka dikush të ta vështirësojë, ta komplikojë, për të krijuar probleme shtesë. Kjo është ajo që më bën shpesh të jemë në karrigen lëkundëse ... dua të vazhdoj por nuk ka rrugëdalje dhe dëshira për të mos vazhduar vetëm rritet. Ajë që fëmijët kanë nevojë për mua më mban në këmbë. "Çdo gjë tjetër është shqetësim".

8. A mundeni dhe si ta trajtoni gjendjen me Kovid-19, si nënë vetëushqyese?

Përgjigjet për këtë pyetje pritëshin, duke marrë parasysh se nuk ka/kishte masa shtetërore për t'u marrë me Kovid-19 ose cilëndo gjendje emergjente, pikërisht për grupin specifik të synuar, nënat vetëushqyese dhe fëmijët nga familjet me një prind.

“Tmerr, katastrofë e paparë!” Me vetë pandeminë, nga momenti që më thirrën dhe shkova ta marr fëmijën më herët nga shkolla, nga 9 marsi, filloi një histori që në fillim menduam se do të kalonte shpejt dhe mbase na dha ca shpresë se do të pushonim dhe do të shkonim në shtëpi me fëmijët. Gjëja e parë që bëra ishte huazimi i parave për të mbushur shtëpinë me ushqim për t'u mbrojtur nga pazaret e përditshme. Blemë gjithçka që ishte më lirë, që mund të dukej si drekë dhe mbushëm dollapët, pas misionit të suksesshëm për të marrë gjërat në shtëpi.

Pastaj ndodhën probleme me punëdhënësit, nuk donin të na lirojnë nga puna mua dhe një nënë tjetër të një fëmije shumë të vogël. Vendimi për të punuar nga shtëpia në fillim gjithashtu na gëzoi, ndërsa në jetën e përditshme pamë se nuk është aq e mundur. Kam punuar nga shtëpia me dy fëmijë, një më i vogël dhe një më i madh. Më duhej të gatuj pesë vakte në ditë, të pastroja nga të gjitha ato gatime, në të njëjtën kohë të kujdesesha për të voglin, të mësoj me të madhin dhe në të njëjtën kohë të kënaqja nevojat e tyre emocionale, por edhe të punoj. Shumë të qara shënuan periudhën e mesme të krizës. Fëmijët qanin, qaja edhe unë më shumë. Gjithë ai pastrim, gatim, qumësht të përmbysur dhe kafe në një kodër dokumentesh ... biskota të njollitura, pantofla të lagura, rroba të ndyra në ton, enët, pjatat sikur të ishim 10 vetë në shtëpi dhe jo unë vetëm me dy fëmijë ... disi i mbijetuam pushimet e zgjatura. Së pari luteshim që të fillojë, pastaj u lutëm që ajo të mbarojë dhe të shkojë në shkollë, kështu që kur filluan ne luteshim që të mos kthehem në punë, siç doli, në mënyrë që të ishte dikush që t'i merrte nga kopshti dhe shkolla ... si t'jua shpjegoj.

Në fund bëmë një kompromis, të punojmë nga puna deri sa janë fëmijët në shkollë, dhe një të tretën e orëve të punës nga shtëpia, sapo të mbarojë shkolla.

“Imagjinoni të gjitha rastet kur gratë u pushuan nga puna për shkak të jofleksibilitetit dhe mungesës së mirëkuptimit nga punëdhënësit, unë i njoh shumë prej tyre.”

E anketuara tjetër tha se ajo kishte probleme me ndejtjen në shtëpi me fëmijët, shteti nuk u përgjigj në asnjë mënyrë, por ajo vetë zhvilloi një sistem mbështetjeje, nga rruga me gjemba, gjë që ajo thotë se ishte e zakonshme. Nuk ka ke qenë e liruar nga puna, sepse e di që nuk ka kush ta zëvendësojë dhe ajo të marrë pagë. Shtoji kësaj pengesat nga kolegët e mi, përse kërkoj të punoj nga shtëpia, po dëshirojnë edhe ata të punojnë nga shtëpia, dhe pastaj pse duhet të dal të marr dhe të dërgoj fëmijë më herët nga shkolla në shtëpi dhe të kthehem

në punë. Puna e saj nuk mund të bëhet nga shtëpia, pasi ajo u përpoq të gjindet. Kjo është arsyeja pse asaj iu desh të linte dy fëmijët vetëm në shtëpi derisa të gjente një fëmijë më të madh se fqinji i cili mbikëqyrte fëmijët për para xhepi dhe disa gjëra të vogla. “Unë nuk e di nëse duhet të merrem me frikën e sëmundjes ngjithëse ose me problemet e neglizhimit të fëmijëve. E di vetëm që gjatë kësaj periudhe u bë e qartë për mua, që nuk mund të përballoj gjëra të rëndësishme që na bëjnë të shëndetshëm, pse vetëm një gjë duhej të ishte më e rëndësishme për mua, të mbesim gjallë, nuk duhet patjetër të jemi të shëndetshëm. Unë nuk dua të flas për mbështetjen e shtetit, natyrisht që nuk e kemi atë, edhe në situata të tilla. Unë nuk jam shumë besimtare, edhe pse të mit dhe të gjithë rreth meje janë. Unë nuk jam si ata një herë në javë në tempull, madje nuk kam kohë të shkoj për një gjë të tillë. Por ama tani lutjet e mia janë më të forta, lutem që të mbijetojmë. Nuk ka besim tek njerëzit, aq më pak në shtet, ne mund t’i lutemi vetëm Zotit. “Të mbijetojmë ashtu disi”.

Në momentin para publikimit të këtij studimi, grupi i katërt i masave është lëshuar nga Qeveria, drejt kategorive më të rrezikuara të qytetarëve. Ky grup masash është i vetmi që mbulon nënat vetëushqyese. Fusha përfshin regjistrimin e nënave vetëushqyese në qendrën ndërkomunale për punë sociale në Shkup dhe në qendrat e tjera lokale për punë sociale. Kërkesa bëhet duke bashkangjitur dokumentacionin për vërtetim, çertifikat nga prindi për vërtetim për beqari ose dokuemntin e divorcit, një vërtetim nga një fëmijë ku nuk figuron prindi dytë ose çertifikatë që vërteton vdekjen e njërit prind.

Fatkeqësisht, asnjë kategori tjetër e prindërve vetëushqyës nuk kishte mundësinë të përdorte këtë masë.

Vetëm dy kategori, nga të tetë (8) të synuara. Kjo do të thotë që fusha e përfituesve të masës është zvogëluar në minimum dhe e gjithë kategoria e nënave vetëushqyese nuk merret parasysh. Ndiurma financiare është një herë 6,000 denarë dhe është e nevojshme të theksohet se është një shumë minimale dhe shumë e parëndësishme për anulimin e dëmit të shkaktuar nga pandemia e Kovid-19.

Rezultatet e marra nga pyetësi i realizuar onlajn në lidhje me gjendjen e pandemisë nga Kovid-19 dhe vetëushqyesit janë si më poshtë:

Nga pyetësi onlajn:

KOVID-19 dhe vetëushqyesit

Hulumtimi tregoi se është e nevojshme t'i kushtohet vëmendja e duhur dhe të vihet theksi në:


Ndikimi i situatës emergjente KOVID-19 në familjet me një prind

Në mënyrë që të ndërtohet një pamje më e qartë e pamundësive të përjetuara nga nënat vetëushqyese në një vend ku nuk ka rend ligjor dhe asnjë mbrojtje institucionale apo sociale, bëhet jashtëzakonisht problematike të funksionosh në kushte emergjente, të tilla si ato gjatë periudhës të KOVID-19. Prandaj, domosdoshmërinë për të shqyrtuar shkallën e rrezikuar, sfidat dhe problemet, i përcjell këtu, në mënyrë që të synojmë segmentet problematike të dhe që duhet të punohet në lidhje me grupin e synuar.

Gjinia

241 responses


- Femërore
- Mashkullore



Përkatësia etnike


241 responses

- Maqedonas/Maqedonase
- Shqiptar/Shqiptare
- Turk/Turke
- Rom/Rome
- Serb/Serbe
- Të tjerë



Mosha


241 responses



Me cilat vështirësi

u ballafaquat gjatë karantinës? (më shumë se një përgjigje është e mundur)


241 responses



Për shkak të mbylljes së përkohëshme të shkollave, çerdheve, qendrave ditore, Ju mbetet pa mbështetjen e zakonshme ditore.

A pati ndikim kjo gjë dhe a e ndryshoi përditshmërinë tuaj?


241 responses



- E ndryshoi plotësisht
- Делумно се промени
- E ndryshoi pjesërisht
- Pjesërisht nuk e ndryshoi

A i kryenit rregullisht detyrat shtëpiake gjatë kohës së karantinës?


241 responses



- Po
- Jo

A kishit/keni qasje të papenguar drejt informatave se si të mbroheni gjatë kohës së Kovid-19?


241 responses



- Po, kisha qasje të papenguar drejt informatave
- Jo, hasja pengesa në qasjen drejt informatave

A mund të kuptoheshin informatat me lehtësi?


241 responses



- Informatat ishin plotësisht të kuptueshme
- Informatat ishin pjesërisht të kuptueshme
- Informatat nuk ishin të kuptueshme

Gjatë KOVID-19 keni pasur / a keni qasje të papenguar në ushqim, ushqime të përshtatshme dhe terapi mjekësore?


241 responses



- Po
- Jo
- Pjesërisht
- Duhej ti siguroj vetë

A kishit / keni nevojë për ndonjë shërbim që nuk mundeshit / nuk mundeni ta merrni si rezultat i pandemisë Kovid-19? Nëse po, ju lutemi tregoni.

241 responses



- Po
- Jo
- Kujdes për fëmijën
- Nuk paguhet alimentacioni

V. Përfundim

Ky rast studimi, veçanërisht në mënyrë empirike, tregon të gjithë larminë e situatave specifike në të cilat zhvillohet jeta e përditshme e nënave vetushqyese, nga të cilat lindin më tej nevojat e ndryshme dhe llojet e mbështetjes që mund dhe duhet t'u sigurohe atyre.

Edhe pse është më e vështirë të bësh përgjithësime empirike nga materiali i mbledhur, sigurisht që është e mundur të nxirren përfundime rreth gjendjes së përgjithshme të vetë-ushqyeshmërisë në shtetin tonë.

Ky hulumtim tregon nevojën për të ndryshuar ligjet në familje kryesisht në drejtim të një rregullimi të ndryshëm të llojeve të ndryshme të familjeve, dhe duke marrë parasysh të gjitha transformimet e familjes dhe jetës familjare. Në veçanti, nevoja për një njohje të ndryshme të amësisë vetushqyese duhet të merret parasysh. Mënyra në të cilën njihen prindërit vetushqyës, në përkufizimin ligjor në RMV, dhe përmes së cilës arsimit i pavarur i vendos fëmijët në një pozitë që të mos jenë në gjendje të ushtrojnë disa të drejta dhe mundësi të nevojshme, e cila në fund të fundit çon në një situatë ku nuk merren parasysh interesat për të mirën e fëmijëve.

Në bashkësitë lokale, mund të punohet në përmirësimin e përgjithshëm të kushteve në të cilat do të harmonizonin biznesin dhe përgjegjësitë familjare. Kopshtet, për shembull, në përgjithësi e përfundojnë punën e tyre shumë më herët sesa prindërit që punojnë mund të përfundojnë përgjegjësitë e tyre të biznesit, veçanërisht kur bëhet fjalë për punë me turne. Orët më të gjata të punës në këto institucione sigurisht që do të kishin efekte pozitive për të gjithë prindërit, veçanërisht prindërit vetushqyës që kujdesen për fëmijët e tyre vetëm.

Shteti, në përputhje me kapacitetet e tij dhe përmes bashkëpunimit ndër-sektorial, mund të sigurojë bashkëfinansim të orarit të plotë të punës së kopshteve.

Gjithashtu është e nevojshme të bashkë financohen dhe / ose të lirohen nga pagesa aktiviteteve të ndryshme jashtëshkollore në shkolla që janë të nevojshme për t'u ofruar fëmijëve nga familje me një prind, të planifikuara me kujdes dhe të drejtuara nga interesat më të mira të fëmijëve.

Në të njëjtin nivel, çështja e kujdesit për fëmijë, e cila është shumë më e gjerë se shqetësimet financiare dhe përfshin çështje të mundësisë së ruajtjes së cilësisë dhe mirëqenies së jetës që pasqyrohet ndër gjenerata, nëse nuk adresohet në mënyrë akute dhe një kohë të gjatë.

Institucionet duhet intensivisht dhe vazhdimisht të mbledhin të dhëna për numrin dhe nevojat e familjeve me një prind. Këto të dhëna të bazuara në kategori të krahasueshme duhet të mblidhen nga institucione të ndryshme relevante për funksionimin e shoqërisë. Vetëm në bazë të një pasqyre reale të situatës për këtë grup të synuar, mund të planifikohen aktivitete që gjenerojnë performancë në mundësimin e një jete mirëqenieje dhe mënjanimin e dëmit tridhjetë vjeçar për të gjithë aktorët në grupin e synuar të familjeve me një prind, të shkaktuara kryesisht nga injoranca institucionale dhe më pas nga diskriminimi i imponuar nga kulturor.

Duke pasur parasysh se ekziston një korrelacion i fortë midis arsimit prindëror dhe statusit shoqëror me nevojat e familjes, autoritetet mund, për shembull, të financojnë përfundimin me kohë të pjesshme të arsimit fillor, të mesëm ose universitar ose forma të tjera të trajnimit (p.sh. kurse të gjuhëve të huaja, kurse pasuniversitare kompjuter, etj.) ose rikualifikim që do t'i bëjë të gjithë anëtarët e familjeve me një prind më konkurrues në tregun e punës dhe do t'u japë atyre mundësi për të drejta dhe mundësi të barabarta, si përmes lirisë ekonomike dhe një jete të përmirësuar.

Masa të tjera që duhet të merren si në nivelin lokal ashtu edhe në atë kombëtar, synojnë përdorimin e mjeteve sistemike si diskriminimi pozitiv. Përmes këtij mekanizmi, për të cilin praktika thotë se duhet të ndodhë në një periudhë afatshkurtër dhe në disa faza, e gjithë kategoria e marginalizuar do të silllet në një gjendje funksionaliteti, përmes mundësive reale për avancim.

Diskriminimi kulturor mund të jetë procesi që çrrënjohet më gjatë dhe më i mundimshëm, por për këtë arsye, puna e vazhdueshme drejt përmirësimit të sistemit arsimor është rekomandimi numër një, sa herë që bëhet fjalë për mbikëqyrjen kulturore.

Problemet dhe sfidat që grupi i synuar i marginalizuar, siç janë prindërit vetushqyes, kanë në rrjedhën më të zakonshme të jetës, bëhen jashtëzakonisht transparentë në situata krizash, siç është pandemia e Kovid - 19.

Në këtë periudhë krize për të gjithë, grupet e synuara më të ndjeshme, përballen me sfida dhe pamundësi të mëdha që i sjellin ata në prag të ekzistencës, pikërisht për shkak të mungesës së masave dhe politikave tipike ligjore, shtetërore për grupin e synuar, kurse shumë më pak mund të theksohen në çdo strategji me një plan veprimi për t'u marrë gjatë krizave të tilla.

Prandaj, rekomandimi i fundit është në përputhje me nevojën e parezistueshme për të krijuar një strategji dhe një plan veprimi për trajtimin e situatave të krizës për kategoritë e marginalizuara të grave me fëmijë, siç janë kryesisht prindërit vetushqyes.



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË



Association for Gender Equality,
Women Freedom and Advancement of
Rights of Single-Parent Families
ONE CAN! - Skopje



HEROINË



HEROINË



HEROINË



HEROINË